




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.21/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
(MBPZHR) - NR. 09/2009 AUTORIZIMI PËR CERTIFIKIM TË
PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.21/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 09/2009 autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.



Në mbështetje të nenit 3 dhe nenit 57 të Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.44/22.12.2008), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.21/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR) -
NR. 09/2009 AUTORIZIMI PËR CERTIFIKIM TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E
BIMËVE**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR.09/2009 autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që e përcakton autorizimin për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Neni 2

Në nenin 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Organ kompetent – nënkupton Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve” zëvendësohet me fjalinë “Organ kompetent – nënkupton Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 3

Neni 3 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

**Neni 3
Aplikimi**

Personat fizik dhe juridik që aplikojnë për tu pajisur me autorizim për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve, duhet të plotësojnë të dhënat që përmban formulari Nr.01/2009 përmes sistemit elektronik.

Neni 4

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

Neni 4

1. Pas pranimit të aplikacionit për autorizim të Produkteve për mbrojtjen e bimëve, organi kompetent brenda 30 ditëve merr vendim për dhënien apo refuzimin e autorizimit duke u bazuar në bazë të vlerësimit të substancave aktive të PMB-ve.

2. Kur një PMB i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, lejohet autorizimi për importim, dhe tregtim dhe për këtë njoftohen personat që kanë aplikuar.

3. Në rastet kur nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, Komisioni për autorizim, vendos për mos dhënien e autorizimit për PMB nëse:

3.1 substancat aktive janë tërheq nga Lisat e (EC) No 1107/2009;

3.2 nuk plotësohen kushtet sipas këtij udhëzimi administrativ.

Neni 5

Neni 5 i Udhëzimit Administrativ bazik i plotësuar/ndryshuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.09/2009 fshihet dhe riformulohet në tërësi, si në vijim:

Neni 5

1. Kërkesa për leje e personit përgjegjës për Barnatore Bujqësore bëhet në Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari.

2. Personi përgjegjës duhet të i plotësoj këto kushte:

2.1. Duhet që biznesi të jetë i regjistruar në ARBK;

2.2. Diplomën e Fakultetit të Bujqësisë: Drejtimi i Përgjithshëm, mbrojtja e bimëve, lavërtari, pemëtari-vreshtari, agro-biznes;

2.3. Pëlqimin për Objektiv nga Kuvendi Komunal përkatës;

2.4. Procesverbalin e hartuar në vendngjarje nga Inspektroaitu Sanitar;

3. Pronarëve të biznesit u ndalohet që të kryejnë veprimtarinë e personit përgjegjës në Barnatore Bujqësore.

4. Në sistemin elektronik krijohet forma e lejes elektronike dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

Neni 6

Pjesë përbërëse e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ është Formulari i përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2010 për Identifikimin e Substancave Aktive për Autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

Neni 7

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ bazik fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

Neni 6

1. Autorizimi për certifikim të produkteve për mbrojtjen e bimëve lëshohet në formë të certifikatës e cila përmban:

1.1. emrin dhe logon e organit kompetent;

1.2. numrin identifikues të certifikatës dhe autorizimit dhe datën e lëshimit;

1.3. të dhënat e personit të regjistruar;

1.4. llojin e veprimtarisë me të cilën ka të bëjë autorizimi;

1.5. vendi i veprimtarisë, nëse ka;

1.6. nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të organit kompetent. Nënshkrimi bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

2. Në sistemin elektronik krijohet certifikata elektronike e cila përmban të gjitha elementet sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes sistemit elektronik.

Neni 8

Neni 7 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 9

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 10

Neni 9 i Udhëzimit Administrativ bazik, Formulari Nr.01/2009 Logoja Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve zëvendësohet Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.

Neni 11

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.02/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.09/2009 Autorizimi për Certifikim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

Neni 12 Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

